



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Data: 23.8.2023

Nr: 726

Ora: 12:00

VENDIM

PËR

“MIRATIMIN E PROGRAMIT TË EDUKIMIT, INFORMIMIT DHE NDËRGJEGJËSIMIT TË ZGJEDHËSVE, PËR ZGJEDHJET E PJESSHME PËR KRYETAR TË BASHKISË KUKËS, TË DATËS 24 SHTATOR 2023”

Bazuar në nenin 19, pika 1, gërma “g” dhe pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve,

V E N D O S:

1. Miratimin e programit për edukimin, informimin dhe ndërgjegjësimin e zgjedhësve, për zgjedhjet e pjesshme për Kryetar të Bashkisë Kukës, të datës 24 Shtator 2023, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare elektronike të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankimi në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve, brenda 24 (njëzet e katër) orëve nga shpallja e tij.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve



Ilirjan CELIBASHI





Edukimi, Informimi dhe Ndërgjegjësimi i Zgjedhësve

ZGJEDHJET E PJESSHME
PËR KRYETARIN E BASHKISË KUKËS
24 SHTATOR 2023



PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Programi për edukimin zgjedhor të shtetasve për zgjedhjet e qeverisjes vendore të bashkisë Kukës, të datës 24 Shtator 2023, është një plan i detajuar i cili përcakton qëllimet dhe objektivat kryesore që duhet të realizohen për edukimin, informimin dhe ndërgjegjësimin e zgjedhësve përgjatë periudhës zgjedhore.

Programi për edukimin e shtetasve për zgjedhjet vendore të bashkisë Kukës të datës 24 Shtator 2023, synon informimin, ndërgjegjësimin mbi të gjithë procesin zgjedhor si dhe rritjen e pjesëmarrësve në zgjedhje.

Programet informuese do të realizohen nëpërmjet bashkëpunimit të KQZ-së me partnerë vendas dhe ndërkombëtarë. Përfshirja e tyre në realizimin e programeve edukuese zgjedhore, ekspertiza, angazhimi dhe mbështetja vlerësohen si komponentë të rëndësishëm në përmbushjen e misionit të KQZ-së.

QËLLIMI

Programi për edukimin zgjedhor të shtetasve për zgjedhjet vendore të bashkisë Kukës të datës 24 Shtator 2023, ka për qëllim të informojë dhe ndërgjegjësoj zgjedhësit mbi aspektet kryesore të procesit zgjedhor. Në mënyrë specifike programi ka si qëllim të informojë dhe edukojë zgjedhësit për datën e zgjedhjeve në lidhje me procesin e verifikimit të emrit në listën e zgjedhësve, si dhe qendrën e votimit ku zgjedhësi voton, informojë dhe edukojë zgjedhësit mbi procedurën e votimit dhe identifikimit elektronik, informojë dhe edukojë zgjedhësit mbi plotësimin korrekt të fletës së votimit, ndërgjegjësimi dhe edukimi i grupeve vulnerabël dhe të rinjve votues për herë të parë për pjesëmarrje në zgjedhje, ndërgjegjësimi dhe edukimi i pakicave kombëtare, informimi i zgjedhësve mbi shkeljet dhe veprat penale që mund të kryhen gjatë procesit zgjedhor dhe i subjekteve zgjedhore, si dhe parandalimi i tyre.



OBJEKTIVAT

- 1** | Informimi, ndërgjegjësimi dhe edukimi i zgjedhësve për listën e zgjedhësve.
- 2** | Ndërgjegjësimi i zgjedhësve për rëndësinë e procesit zgjedhor dhe subjekteve zgjedhore mbi zhvillimin e zgjedhjeve të lira dhe të pandikuara.
- 3** | Sensibilizimi i grupeve vulnerabël, të rinjve, kryesisht votues për herë të parë, gratë, ku qëllimi është rritja e pjesëmarrjes së tyre në zgjedhje.
- 4** | Informimi i administratës publike për ndalimet dhe kriteret ligjore për zgjedhjet.
- 5** | Informimi dhe edukimi i zgjedhësve mbi mënyrën e votimit, përmbajtjen e fletës së votimit dhe shënimi korrekt i saj.

REALIZIMI I OBJEKTIVAVE

1

Informimi, ndërgjegjësimi dhe edukimi i zgjedhësve për listën e zgjedhësve.

Ky objektiv ka për qëllim të informojë zgjedhësit mbi listën e zgjedhësve dhe qendrën e tyre të votimit, nëse kanë pasaktësi se ku duhet të drejtohen si dhe mjetet e ndryshme të komunikimit ku ata mund të gjejnë gjithë informacionin mbi procesin zgjedhor.

Mjetet e komunikimit



media sociale

Do të shpërdahet informacioni nëpërmjet spoteve, banerave dhe mesazheve të ndryshme mbi listën e zgjedhësve dhe qendrën e votimit




KQZShqipëri




takime me target-grupe

Do të zhvillohen takime me votues për herë të parë, gratë dhe grupe të ndryshme vulnerabël të cilët do të informohen se ku mund të gjejnë emrin e tyre në listën e zgjedhësve dhe qendrën e votimit.



Aplikacioni KQZ

Nëpërmjet aplikacionit mund të gjendet qendra e votimit nga çdo zgjedhës nëpërmjet rubrikës "Ku votoj"



webfaqja kqz.gov.al

Në website e kqz-së do të publikohet i gjithë informacioni mbi listën e zgjedhësve dhe nëpërmjet web-it mund të gjendet qendra e votimit nga çdo zgjedhës.

2

Ndërgjegjësimi i zgjedhësve për rëndësinë e procesit zgjedhor dhe subjekteve zgjedhore mbi zhvillimin e zgjedhjeve të lira dhe të pandikuara.

Ky objektivi ka për qëllim informimin e zgjedhësve dhe subjekteve zgjedhore mbi veprat penale dhe shkeljet që mund të kryhen gjatë procesit zgjedhor, si edhe parandalimi i tyre për të garantuar standardet zgjedhore.

Mjetet e komunikimit



Do të shpërdahet informacioni nëpërmjet spoteve, banerave dhe mesazheve mbi parandalimin e veprave penale përgjatë procesit zgjedhor.



KQZShqiperi



Do të transmetohet spot mbi veprat penale që mund të kryhen gjatë procesit zgjedhor në televizionet lokale që mbulojnë bashkinë Kukës.



Do të zhvillohen takime me votues për herë të parë, gratë dhe grupe të ndryshme vulnerabel të cilët do të informohen mbi veprat penale dhe si t'i parandalojnë.



Do të vendosen postera informues në të gjitha qendrat e votimit në Bashkinë Kukës mbi veprat penale në zgjedhje.



Aplikacioni KQZ

Nëpërmjet aplikacionit mund të gjendet sesioni "Denonco" ku cilido mund të denoncojë shkeljet e ndryshme zgjedhore.



webfaqja kqz.gov.al

Në website e KQZ do të publikohet i gjithë informacioni mbi veprat penale.



3

Sensibilizimi i grupeve vulnerabël, të rinjve, kryesisht votues për herë të parë, gratë, ku qëllimi është rritja e pjesëmarrjes së tyre në zgjedhje.

Ky objektivi ka në fokus sensibilizimin e zgjedhëseve gra dhe të rinjtë, për të shmangur fenomenin e votimit familjar, për të votuar në mënyrë të lirë dhe të pandikuar, rritja e pjesëmarrjes së votuesve për herë të parë, si dhe përfshirja e tyre në proceset e ndryshme zgjedhore.

Mjetet e komunikimit




Do të shpërdahet informacioni nëpërmjet spoteve, banerave dhe mesazheve të ndryshme nga të rinjtë dhe gratë për pjesëmarrje në zgjedhje.




KQZShqiperi



Do të zhvillohen takime me votues për herë të parë, gratë dhe grupe të ndryshme vulnerabël ku do të informohen mbi të gjitha hapat e procesit zgjedhor.



Nëpërmjet aplikacionit mund të gjendet qendra e votimit nga çdo zgjedhës, mund të denoncohet çdo parregullsi që mund të vërehet përgjatë procesit zgjedhor apo edhe ditën e zgjedhjeve.



Në website e KQZ do të publikohet i gjithë informacioni mbi procesin zgjedhor në rubrikën "Edukimi i Zgjedhësve"

4 | Informimi i administratës publike për ndalimet dhe kriteret ligjore për zgjedhjet.

Ky objektivi ka për qëllim kryesor ndërgjegjësimin e punonjësve të administratës vendore gjatë periudhës zgjedhore, mbi shkeljet ligjore dhe veprat penale që mund të kryhen gjatë procesit zgjedhor, parandalimi i tyre, si dhe raportimi i çdo rasti në portalin e dedikuar për monitorimin e veprimtarisë, sjelljes dhe përdorimit të burimeve shtetërore.

Mjetet e komunikimit



Do të shpërdahet informacioni nëpërmjet spoteve, banerave dhe thirrjeve për parandalimin e burimeve shtetërore përgjatë fushatës zgjedhore nga administrata vendore, si dhe parandalimi i pjesëmarrjes në fushatën zgjedhore të punonjësve shtetërorë përgjatë orarit zyrtar.



KQZShqiperi



Aplikacioni KQZ

Nëpërmjet aplikacionit mund të gjendet sesioni **"Denonco"** shkeljet zgjedhore



webfaqja kqz.gov.al

Në website e KQZ do të publikohet i gjithë informacioni mbi shkeljet dhe parandalimi i veprave penale.

5

Informimi dhe edukimi i zgjedhësve mbi mënyrën e votimit, përmbajtjen e fletës së votimit dhe shënimi korrekt i saj.

Qëllimi i këtij objekti është që zgjedhësit të jenë të përgatitur ditën e votimit për hapat që duhet të ndjekin në qendrën e votimit dhe për plotësimin korrekt të fletës së votimit në mënyrë që vota e tyre të jetë e vlefshme.

Mjetet e komunikimit



Do të shpërdahet informacioni nëpërmjet spoteve, banerave dhe mesazheve mbi hapat që duhet të ndjekë zgjedhësi në qendrën e votimit ditën e zgjedhjeve si dhe plotësimin korrekt të fletës së votimit.



Do të transmetohet spot në televizionet lokale që mbulojnë bashkinë Kukës mbi hapat që duhet të ndjekë zgjedhësi në qendrën e votimit dhe plotësimin korrekt të fletës së votimit.



Do të zhvillohen takime me votues për herë të parë, gratë dhe grupe të ndryshme vulnerabël të cilët do të informohen mbi hapat që duhet të ndjekë zgjedhësi në qendrën e votimit ditën e zgjedhjeve si dhe plotësimin korrekt të fletës së votimit.



Do të vendosen postera informues në të gjitha qendrat e votimit në Bashkinë Kukës mbi hapat duhet të ndjekë zgjedhësi në qendrën e votimit ditën e zgjedhjeve dhe plotësimin korrekt të fletës së votimit.)



Aplikacioni KQZ

Nëpërmjet aplikacionit mund të gjendet sesioni **“Si mund të votoj”** i cili shpjegon me video të gjitha hapat duhet të ndjekë zgjedhësi në qendrën e votimit dhe plotësimin korrekt të fletës së votimit.



webfaqja kqz.gov.al

Në website e KQZ do të publikohet i gjithë informacioni në rubrikën **“Edukimi i Zgjedhësve”** mbi hapat duhet të ndjekë zgjedhësi në qendrën e votimit dhe plotësimin korrekt të fletës së votimit.

Sfidat e Programit

Sfida kryesore e këtij programi edukimi dhe ndërgjegjësimi është realizimi i tij në kohë dhe me standard, për të arritur qëllimet dhe përmbushur objektivat, si dhe në dhënien e marrjen e informacionit të nevojshëm rreth procesit zgjedhor që do të zhvillohet në 24 Shtator 2023.

Duke vlerësuar faktin që koha në dispozicion është shumë e shkurtër, si dhe konsensusin e të gjithë aktorëve të përfshirë në proces, zbatimi i këtij programi është sfidë për përmbushjen e misionit të KQZ-së.



2 0 2 3